



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:058742

Datë: 14.08.2024

Numri i dokumentit: 06051583

P.nr.89/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi në çështjen penale kundër të pandehurit M.S., nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.413/22 të datës 28.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, me datën 17.07.2024, në praninë e Prokurorit të shteti Shaqir Sedolli, të pandehurit M.S., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 17.07.2024, më datë 14.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: M.S. nga i ati R..., e ëma Gj..., e vajzërisë V..., i lindur me ... në Korçë-Republika e Shqipërisë, tani jeton në Vushtrri rr. ”...” nr..., me numër personal të letërnjoftimit ..., ka të kryer shkollën Filllore, i gjendjes së dobët ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 02.02.2022 rreth orës 17:00, në parkun e qytetit në Vushtrri, në mënyrë të paautorizuar ka poseduar katër qese të vogla me substancë narkotike, marihuana (kanabis), e cila përmban substancën psikotrope tetrahidrokanabinol (THC) në peshë rreth 1.71 gram, kur me rastin e kontrollimit të të njëjtit i cili ka qenë në shoqëri me L.A., nga ana e zyrtarëve policor, sasia e cekur prej 4 kater qeseve e gjetur te i njëjti i është marrë,

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 4, 7, 17, 38, 42, 48, 49, 69, 70, 71 dhe neni 269 par.1, të KPRK-së dhe neneve 364, 449 dhe 463 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej dyqind (200) Euro, e cila gjobë nuk do të ekzekutohet ne qofte se i pandehuri ne periudhën verifikuese ne kohëzgjatje prej një viti, nuk kryen vepër tjetër penale, e po ashtu kumulativisht gjykata te pandehurit i shqipton,

II. DENIM ME BURG në kohëzgjatje prej tre muaj, i cili dënim me burg nuk do të ekzekutohet pasi që me pëlqimin e të akuzuarit, gjykata i ka zëvendësuar dënimin e shqiptuar me burg në dënim me 120 (njëqindnjëzet) orë pune pa pagesë te cilat do ti kryej ne afat prej 1 viti.

- a) Shërbimi Sprovues do të mbikëqyr zbatimin e dënimit për punë me dobi të përgjithshme, do të përcaktoj llojin e punës me dobi te përgjithshme, do të caktoj organizatën ku do të kryhet puna me dobi të përgjithshme si dhe të vendos për ditët e javës gjate te cilave puna me dobi te përgjithshme do te kryhet. Urdhërohet i akuzuari M.S. qe te mbaje kontakte me Shërbimin Sprovues deri ne përmbushjen e plote të dënimit prej 120 ore pune pa pagese ne dobi te përgjithshme ne kohëzgjatje prej një viti.
- b) Ne qofte se i akuzuari nuk e kryen punën ne dobi te përgjithshme, Gjykata mund ta revokoj vendimin me urdhër me pune ne dobi te përgjithshme (neni 57 par 5 KPRK-së) apo urdhëron dënim me burg ku një (1) dite burgim do te urdhërohet për çdo 8 ore pune ne dobi te përgjithshme qe nuk është kryer.
- c) Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 30€ (tridhjetë euro), ne emër të pagesës për kompensimin e viktimave të krimit 20€ (njëzet euro).

Ne vështrim te dispozitave te nenit 269 par 3 te KPRK-së substanca psikotrope, konfiskohet.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.413/22 të datës 28.03.2022, kundër të pandehurit M.S., nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit për fajësinë

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datën 17.07.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën duke shtuar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe ka shtuar se do ta kisha lutur gjykatën që të më falë kësaj here pasi nuk kam as të holla të paguajë, dhe ndërkohë më duhet të kujdesëm për vajzën e mitur 9 vjeçare dhe nënën, tani e kam lënë përdorimin e marihuanës, qe një vit e gjysmë, pasi që e kam kuptuar se përdorimi i marihuanës vetëm të shkakton probleme, të harxhon lekun dhe nuk ka ndonjë dobi prej saj, kështu që tani fare nuk e përdor. Në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, duke shtuar se i jap fjalën gjykatës se nuk do të bëjë as më të voglin gabim.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë, i propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit propozon që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësues edhe renduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallën e rrezikshmërisë që kjo vepër paraqet për shoqëri, po ashtu prokurori i shtetit propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese, sidomos nëse edhe më parë është dënuar për vepra të njëjta penale dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka miratuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: deklarata e te pandehurit dhënë ne polici dt. 02.02.2022; deklarata e dëshmitarit dhënë në polici dt. 02.02.2022; raporti i oficerit dt. 02.02.2022; raporti policor dt. 02.02.2022; raporti i shpejte dt. 02.02.2022; vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve dt. 02.02.2022; fotodokumentacioni ne pesë shtojca; raporti i ekspertizës nga Agjencia e Kosoves per Forenzikë dt. 18.02.2022; duke konsideruar edhe pranimin e fajësisë se te pandehurit edhe gjatë fazës se hetimeve por edhe ne seancën për shqyrtim fillestar e qe te gjitha këto prova vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale qe me aktakuzë i vihet ne barrë.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1, të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 269, par.1, të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen “Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.” e që sipas vlerësimit të gjykatës, me veprimet e të pandehurit, është konsumuar kryerja e kësaj vepre penale.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar por pa u kufizuar në nenin 69 dhe 70 e 71 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethana lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dhe zotimin e te njëjtit se i njëjti nuk do të përsërisë apo kryej vepra tjera penale, pasi që sipas deklarimit të te njëjtit tani me e ka braktisur përdorimin e marihuanes.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat (rënduese dhe lehtësuese) të cekura më lartë, ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për aplikim të dispozitave për zbutjen e dënimit nga 71 i cili parasheh “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.1. kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet; 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose 1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.” dhe 72 par. 1, pika 1.6 në të cilin edhe parasheh “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: “ 1.5. nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”. Po ashtu gjykata, pas aplikimit të dispozitave të mësipërme, me rastin e shqiptimit të dënimit ka aplikuar edhe nenin 45, të KPRK-së, ku parashihet “Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme”.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat (rënduese dhe lehtësuese) të cekura më lartë, ka vlerësuar se në rastin konkret, se dënimi i kushtëzuar me gjobë në shumë dyqind (200) Euro dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, e i cili me pëlqimin e te pandehurit i është zëvendësuar me 120 orë pune me interes të përgjithshëm, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 par.1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.89/22, datë 14.08.2024

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.